

Nr. _____ Prot.
Datë _____
Bashkia e Tiranës

KËRKESE

BASHKISË SË TIRANËS **DREJTORIA E TRANSPORTIT E TRAFIKUT RRUGOR** **PËR** **LIÇENCË PËR SHËRBIME TË RREGULLTA TË SPECIALIZUARA**

Unë i nënshkruari/.....në emër të subjektit Fizik/Juridik.....banues/me seli në adresë
....., Tel , cel.....dhe me dokument identifikimi
....., Nr.....

Bazuar në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), ligjin nr.8308, dt 18.03.1998, “Për transportet Rrugore” (i ndryshuar), ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar); VKM-së nr. 325, datë 19.3.2008, për “Miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë” (i ndryshuar), udhëzimin nr.15, datë 24.07.2007, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” (i ndryshuar), vendimin nr. 89, datë 14.02.2018, “Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe të studenteve”, vendimin nr. 520, datë 13.07.2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 325, datë 19.03.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumentave zyrtare, të caktuara për këto operatorë, (i ndryshuar), udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, për “Kriteret, rregullat dhe dokumentacioni për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve me autobus brenda vendit” (i ndryshuar).

KËRKOJ:

Të pajisem me liçencë për shërbime të rregullta të specializuara.

- Shtëpi – punë, të punonjësve;
- Shtëpi – institucion shkollor, të nxënësve dhe studentëve;

Bashkëlidhur dorëzoj dokumentet e mëposhtme:

1. Formularin e autodeklarimit;
2. Vetëdeklarimin për reputacionin e mirë të përfaqësuesit ligjor të subjektit transportues, drejtuesit/drejtuesve të veprimtarisë drejtuesit/drejtuesve të mjetit / mjeteve;
3. Dokument nga një institucion bankar ose financiar, që vërteton gjendje të qëndrueshme financiare, i cili mund të jetë:
- a. Një dokument i lëshuar nga shoqëri sigurimi
- b. Një dokument/garanci bankare; (140.000 leke për mjetin e pare dhe 70.000 leke për cdo mjet shtesë);
4. Dokumentin e zotërimit të kompetencës profesionale dhe eksperiencës, kontratën e punës me kohëzgjatje 5-vjeçare, me person që plotëson kriterin e kompetencës profesionale (ÇKP) (fotokopje të noteruar) deklaraten noteriale që nuk është i punësuar në më shumë se 3 subjekte brenda të njëjtit rreth ose që nuk menaxhon më tepër se 36 mjete;
5. Regjistrimi në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Bisnesit (QKB), ku objekti i veprimtarisë duhet të jetë “Transport Udhëtarësh brenda vendit”, mjetet duhet të jenë të pasqyruara në ekstrakt;
6. Kontratën ndërmjet organizatorit të transportit dhe subjektit, e cila shërben si dokument kontrolli për këto shërbime;
7. Pika e nisjes dhe mbërritjes;

8. Listën e punonjësve/nxënësve;
9. Lejen e qarkullimit (fotokopje e noteruar);
10. Çertifikatën e kontrollit teknik të mjeteve (fotokopje e noteruar);
11. Akt-vlerësimin e plotësimit të kushteve të komoditetit të mjeteve në transportin e udhëtarëve brendavendit lëshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), sipas udhëzimi nr. 1649, datë 16.08.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, (i ndryshuar);
12. Siguracionin e pasagjerëve (fotokopje e noteruar);
13. Çertifikatën e kalibrimit të tahogرافit (fotokopje e noteruar);
14. Lejen e drejtimit për drejtuesin e mjetit, me kategoritë përkatëse për mjetin që drejton;
15. Çertifikatën e AftësisëProfesionale (ÇAP) përdrejtuesit e mjetevenëpërputhje me udhëzimin nr. 3606/2, datë 28.10.2011 “Për pajisjen e përdoruesve të mjeteve rrugore të kategorive C, CE, D (*) dhe DE, me çertifikatën e aftësisimit profesional (ÇAP)”, të ndryshuar;
16. Sigurimin e përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjete (fotokopje e noteruar);
18. Në rast se destinacioni i këtij shërbimi del jashtë juridiksionit të një bashkie ku ndodhet pika e nisjes, shërbimi kryhet vetëm pas një marrëveshje bashkëpunimi të lidhur midis Bashkisë si pike nisje dhe Bashkisë së destinacionit, si pike mbërritje;
19. Për raste të veçanta, në varësi të infrastructures rrugore dhe me kërkesë të ndërmarrjeve dhe institucioneve arsimore, përdorimi i autoveturave me 8+1 ndenjese për transportin e punonjësve dhe nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar bëhet vetëm me miratimin e Bashkisë;
20. Si dhe çdo dokument tjetër të kërkuar nga Bashkia e Tiranës.

KËRKUESI _____

Plotësohet nga specialist i Bashkisë

(SPECIALISTI) _____ Tiranë, më / /

1. Tarifa për pajisje me licencë për shërbime të rregullta të specializuara me afat vlefshmërie pesë vjet është 20.000 lekë.
2. Tarifa për pajisje me çertifikatë për shërbime të rregullta të specializuara me afat vlefshmërie pesë vjet është 7500 lekë.